



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 379/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha, Kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidatja për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Labinote Demi - Murtezi, nga koalicioni LDK-AKR, dega në Gjilan, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Labinote Demi - Murtezi, kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit LDK-AKR, dega në Gjilan.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017 në ora 12:00, nga Labinote Demi - Murtezi kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR, në të cilën ankesë është pretenduar se me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), numëri i përgjithshëm i votave të saj sipas KQZ-së është 1818, ndërkaq duke u bazuar në formularët e Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Gjilan, dëshmojnë për 1839 vota, pra bëhet fjalë për 21 vota diferencë.

Parashtruesia e ankesës ka kërkuar nga PZAP-i që të rihapen kutit e votimit në komunën e Gjilanit, në mënyrë që të dëshmohet mospërputhja e Formularëve të Rezultateve për Kandidat (FRK), dhe në cilësi të provës ka bashkangjitur kopjen e formularëve të siguruara nga KKZ në Gjilan.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesia e ankesës me ankesën e saj kërkon që të rinumërohen të gjitha kutitë e votimit në Komunën e Gjilanit,

sepse nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ e njejta posedon 1818 vota, ndërsa sipas Formularit për Rezultatet e Kandidatëve FRK të KKZ-së, ka mungesë të votave në 1839 vota, ku diferenca sipas parashtruesit të ankesës është 21 vota.

Mirëpo nga pretendimet ankimore me asnjë provë bindëse nuk është dëshmuar se në cilin vendvotim VV iu janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i ankesën e parashtrueses e konsideron si të përgjithshme dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesja e ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesen e ankesës, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë. Ndërsa provat e parashtruara në ankesë sipas vlerësimit të PZAP-it, nuk paraqesin referencë ligjore në mbështetje të pretendimeve në ankesë e as bazë të vlefshme ligjore për marrjen e vendimit më të favorshëm për ankuesen.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankueses e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.379/2017 më datën 02.07.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.